



USHTRIA



Viti i 79-të i botimit Nr. 16 (827972)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 24 prill 2026



Krahët e Shqipërisë: Nga ëndrra në forcë ajrore moderne

» faqe 6



SHQIPËRIA RINGRE INDUSTRINË USHTARAKE: DRONË, ARMË DHE MUNICIONE 'MADE IN ALBANIA'

Në seancën parlamentare të ditës së enjte, ministri i Mbrojtjes, Ermal Nafi, prezantoi projektin për ngritjen e shoqërisë KAYO, një strukturë e re që synon zhvillimin e industrisë ushtarake në vend, përmes bashkëpunimit me kapitalin privat dhe partnerë ndërkombëtarë. Gjatë fjalës së tij, ministri Nafi theksoi se KAYO nuk është konceptuar si një kompani klasike prodhuese, por si një platformë bashkëpunimi që do të mundësojë prodhimin e pajisjeve ushtarake për nevojat e Forcave të Armatosura të Shqipërisë, si dhe për eksport...

faqe 3



VIZITA E NIVELIT TË LARTË NGA TURQIA FORCON PARTNERITETIN STRATEGJIK NË MBROJTJE

Tiranë, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralletjënant Arben Kingji, priti në një takim zyrtar homologun e tij nga Turqia, Gjeneral Selçuk Bayraktaroğlu, në një vizitë që vlerësohet si një moment i rëndësishëm për thellimin e bashkëpunimit strategjik mes dy vendeve aleate. Kjo vizitë konfirmoi edhe një herë marrëdhëniet e qëndrueshme dhe të konsoliduara mes Shqipërisë dhe Turqisë në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, duke reflektuar një partneritet të ndërtuar mbi besim të ndërsjellë dhe interesa të përbashkëta në kuadër të NATO-s...

faqe 4



LAMTUMIRË KOLOSIT TË MENDIMIT: REXHEP QOSJA NË PËRJETËSI

Një mendje e madhe ndalet: Rexhep Qosja lë pas një trashëgimi të pavdekshme. Ndarja nga jeta e akademikut Rexhep Qosja shënon një nga humbjet më të mëdha për kulturën, shkencën dhe ndërgjegjen kombëtare shqiptare. Studiues, shkrimtar, kritik letrar dhe intelektual i përmasave mbarëkombëtare, ai ishte një prej figurave më të rëndësishme të mendimit shqiptar në shekujt XX dhe XXI. Me ikjen e tij, nuk shuhet vetëm një jetë e gjatë dhe e pasur, por mbyllet një epokë e të menduarit kritik, e guximit intelektual dhe e përkushtimit ndaj çështjes kombëtare...

faqe 5

Shqipëri–Kroaci: Partneritet strategjik në shërbim të sigurisë dhe integritit euroatlantik

Në Zagreb, ministri i Mbrojtjes, Ermal Nufi zhvilloi një takim të rëndësishëm me presidentin e Republikës së Kroacisë, Zoran Milanović, duke konfirmuar edhe një herë marrëdhëniet e ngushta mes dy vendeve aleate në kuadër të NATO-s.

Takimi u zhvillua në një frymë bashkëpunimi dhe mirëkuptimi të plotë, ku të dyja palët theksuan rëndësinë e forcimit të mëtejshëm të partneritetit strategjik. Në qendër të diskutimeve ishte objektivi i përbashkët për ruajtjen dhe forcimin e paqes dhe stabilitetit në Evropën Juglindore, një interes jetik për sigurinë rajonale dhe më gjerë.

Sa i përket bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, u nënvizua se marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Kroacisë po zhvillohen në mënyrë të qëndrueshme brenda kornizës së Aleancës. Fokus i veçantë i këtij bashkëpunimi mbetet zhvillimi i kapaciteteve ushtarake, rritja e profesionalizmit përmes trajnimeve të avancuara dhe edukimit ushtarak, si dhe forcimi i ndërveprueshmërisë operacionale ndërmjet forcave të armatosura të dy vendeve.

Një aspekt i rëndësishëm i diskutimeve ishte intensifikimi i stërvitjeve të përbashkëta dhe pjesëmarrja aktive në operacionet e përbashkëta të NATO-s, duke kontribuar në rritjen e gatishmërisë dhe efikasitetit të forcave në përballje me sfidat e sigurisë.

Po ashtu, gjatë takimit u trajtua edhe dimensionin evropian i bashkëpunimit, ku një pikë kyçe ishte krijimi i kuadrit ligjor për ofrimin e asistencës teknike nga Kroacia në mbështetje të procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Nga ana e tij, Presidenti kroat, Zoran Milanović, rikonfirmoi angazhimin e vendit të tij për të vijuar



bashkëpunimin me Shqipërinë edhe në kuadër të nismave shumëpalëshe, veçanërisht përmes Kartës së Adriatikut (A5), e mbështetur nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Ky takim dëshmon qartë se marrëdhëniet Shqipëri–Kroaci mbeten një model bashkëpunimi të suksesshëm në rajon, të bazuar në vlera të përbashkëta euroatlantike dhe në angazhimin për paqe, stabilitet dhe zhvillim të qëndrueshëm.

Një partneritet i konsoliduar që vijon të forcohet në shërbim të sigurisë rajonale dhe integritit evropian.

Shqipëri–Kosovë: Bashkëpunim i forcuar ushtarak dhe suksese të përbashkëta në garën “Ushtari më i Mirë”

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Gjenerallejtënant Arben Kingji, zhvilloi një takim të rëndësishëm me Komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Bashkim Jashari, ku në fokus ishin zhvillimet më të fundit në fushën e sigurisë dhe thellimi i bashkëpunimit ushtarak mes dy vendeve.

Takimi u zhvillua në një frymë vëllazërore dhe bashkëpunimi të ngushtë, duke reflektuar marrëdhëniet e forta ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës në fushën e mbrojtjes. Dy drejtuesit e lartë ushtarakë diskutuan mbi rritjen e bashkëpunimit në fusha me interes të përbashkët, duke përfshirë shkëmbimin e eksperiencave, zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe intensifikimin e aktiviteteve të përbashkëta stërvitore.

Një moment i veçantë i këtij angazhimi ishte pjesëmarrja e përbashkët në ceremoninë e ndarjes së certifikatave për garën “Ushtari më i Mirë”, e zhvilluar në Kosovë, ku morën pjesë efektivë nga Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH) dhe Forca e Sigurisë së Kosovës.

Së bashku, Gjeneral Arben Kingji dhe Gjeneral Bashkim Jashari shpërndanë certifikatat dhe përgëzuan fituesit e kësaj gare prestigjioze, ku efektivët shqiptarë u renditën në vendin e parë, duke dëshmuar nivel të lartë profesionalizmi, përgatitje fizike dhe shpirt gare.

Ky sukses i përbashkët është një tregues i qartë i cilësisë



së trajnimit dhe përkushtimit të trupave, si dhe një dëshmi e forcimit të bashkëpunimit operacional ndërmjet dy forcave.

Takimi dhe aktivitetet e përbashkëta dëshmojnë edhe një herë se Shqipëria dhe Kosova vijnë të ndërtojnë një



partneritet të qëndrueshëm dhe strategjik në fushën e sigurisë, në funksion të paqes, stabilitetit dhe zhvillimit të mëtejshëm të kapaciteteve ushtarake.

Një bashkëpunim vëllazëror që sjell rezultate konkrete dhe forcon sigurinë në rajon.

Shqipëria ringre industrinë ushtarake: Dronë, armë dhe municione ‘Made in Albania’

Në seancën parlamentare të ditës së enjte, ministri i Mbrojtjes, Ermal Nufi, prezantoi projektin për ngritjen e shoqërisë KAYO, një strukturë e re që synon zhvillimin e industrisë ushtarake në vend, përmes bashkëpunimit me kapitalin privat dhe partnerë ndërkombëtarë.

Gjatë fjalës së tij, ministri Nufi theksoi se KAYO nuk është konceptuar si një kompani klasike prodhuese, por si një platformë bashkëpunimi që do të mundësojë prodhimin e pajisjeve ushtarake për nevojat e Forcat e Armatosura të Shqipërisë, si dhe për eksport.

“Shoqëria KAYO është konceptuar jo si kompani prodhuese, por qëllimi i saj është bashkëpunimi, në mënyrë që të prodhohen produkte ushtarake për Forcat e Armatosura apo për eksport. Ky është një model ndërkombëtar, ku angazhohen kapitale private për të ngritur industri ushtarake”, - deklaroi ministri.

Ministri Nufi nënvizoi se Shqipëria ka një traditë të konsoliduar në prodhimin ushtarak, duke kujtuar se në të kaluarën vendi ka qenë i angazhuar në prodhimin e armëve, municioneve dhe lëndëve plasëse, dhe se krijimi i një kompanie shtetërore që garanton rezerva municioni dhe zhvillimin e linjave të reja prodhuese është një domosdoshmëri në funksion të sigurisë kombëtare.

Ministri bëri të ditur gjithashtu se shoqëria do të funksionojë mbi bazën e partneritetit publik-privat, ku kapitali kryesor do të sigurohet nga investitorë privatë. Në këtë kuadër, janë parashikuar edhe bashkëpunime ndërkombëtare, përfshirë marrëveshje me partnerë nga Izraeli, me qëllim përfitimin e teknologjive të testuara në kushte reale operationale.

Një ndër objektivat kryesorë të KAYO-s do të jetë prodhimi i dronëve, krahës armëve dhe municioneve, duke synuar modernizimin e kapaciteteve të mbrojtjes dhe rritjen e autonomisë strategjike të vendit.

Në aspektin ekonomik dhe social, ministri Nufi theksoi se projektet e lidhura me këtë iniciativë do të hapin rreth 1000 vende të reja pune në vend, kryesisht në fabrikat e prodhimit të municioneve.

Sipas tij, shteti pritët të investojë rreth 3 milionë euro në këtë shoqëri, ndërsa përfitimet e pritshme llogariten në vlerën 300–400 milionë euro, duke e kthyer këtë iniciativë në një projekt me ndikim të rëndësishëm si në sigurinë kombëtare, ashtu edhe në zhvillimin ekonomik të vendit.



Prishtina dhe Tirana thellojnë bashkëpunimin në industrinë e mbrojtjes

Në Prishtinë, ministri i Mbrojtjes, Ermal Nufi, zhvilloi një takim të ngrohtë dhe vëllazëror me homologun e tij, Ejup Maqedonci, ku u rikonfirmua partneriteti i fortë strategjik mes dy vendeve.

Gjatë takimit, ministri Nufi theksoi se Kosova mbetet një prioritet strategjik kombëtar për Shqipërinë, duke nënvizuar angazhimin e palëkundur për integrimin e saj në strukturat euroatlantike dhe në nismat rajonale të sigurisë.

Të dy ministrat vlerësuan nivelin e lartë të bashkëpunimit dypalësh, i cili po zhvillohet me intensitet dhe efikasitet të shtuar. Një fokus i veçantë iu kushtua angazhimit të ri në industrinë e mbrojtjes, e konsideruar si një sektor kyç për forcimin e sigurisë dhe rritjen e kapaciteteve ushtarake, ku zhvillimi teknologjik dhe industrial ecin paralelisht me thellimin e marrëdhënieve strategjike.

Gjithashtu, u theksua rëndësia e bashkëpunimit të ngushtë mes Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës, si një shtyllë e fortë për garantimin e sigurisë së përbashkët dhe stabilitetit në rajon.

Takimi në Prishtinë dëshmon edhe një herë përkushtimin e dy vendeve për të avancuar bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes dhe për të ndërtuar një të ardhme të sigurt euroatlantike.

Një partneritet vëllazëror që forcohet çdo ditë në shërbim të sigurisë dhe paqes në rajon.



Trajnim i përbashkët Shqipëri-Itali për rritjen e aftësive në qitjen precize

Efektivë të Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë zhvilluan një trajnim të përbashkët me homologët e tyre nga Italia, të fokusuar në përmirësimin e aftësive dhe teknikave në qitjen precize (sniper). Ky aktivitet u realizua në kuadër të bashkëpunimit dypalësh në fushën e mbrojtjes, me synim rritjen e kapaciteteve taktike dhe operationale të efektivëve, si dhe forcimin e ndërveprueshmërisë mes dy forcave partnere.



Gjatë trajnimit, efektivët shkëmbyen eksperiencat dhe praktikatat më të mira në përdorimin e teknikave bashkëkohore të qitjes precize, duke rritur nivelin e përgatitjes profesionale dhe efikasitetin në misione të ndryshme.

Aktivitetet e tilla përbëjnë një element të rëndësishëm në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar të Forcave të Armatosura, duke kontribuar drejtpërdrejt në rritjen e standardeve operationale dhe në përmbushjen e detyrimeve në kuadër të NATO-s.

Një tjetër hap konkret drejt forcimit të aftësive dhe bashkëpunimit ndërmjet forcave aleate.



Tiranë, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji, priti në një takim zyrtar homologun e tij nga Turqia, Gjeneral Selçuk Bayraktaroğlu, në një vizitë që vlerësohet si një moment i rëndësishëm për thellimin e bashkëpunimit strategjik mes dy vendeve aleate.

Kjo vizitë konfirmoi edhe një herë marrëdhëniet e qëndrueshme dhe të konsoliduara mes Shqipërisë dhe Turqisë në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, duke reflektuar një partneritet të ndërtuar mbi besim të ndërsjellë dhe interesa të përbashkëta në kuadër të NATO-s.

Gjatë takimit, gjenerallejtënant Arben Kingji theksoi rëndësinë e rritjes së bashkëpunimit në zhvillimin e kapaciteteve njerëzore përmes programeve të avancuara të trajnimit dhe edukimit ushtarak. Një vëmendje e veçantë iu kushtua edhe rritjes së ndërveprueshmërisë operacionale përmes intensifikimit të stërvitjeve të përbashkëta, si dhe shkëmbimit të eksperiencave në fusha me interes të ndërsjellë.

Ai shprehu gjithashtu mirënjohjen për mbështetjen e vazhdueshme që Forcat e Armatosura të Turqisë i kanë dhënë Shqipërisë ndër vite, duke e cilësuar këtë ndihmë si thelbësore për modernizimin dhe rritjen e kapaciteteve operacionale të Forcave tona të Armatosura.

Nga ana e tij, Gjeneral Selçuk Bayraktaroğlu rikonfirmoi angazhimin për thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ushtarak mes dy vendeve dhe vlerësoi rolin aktiv të Shqipërisë në ruajtjen e sigurisë rajonale dhe më gjerë.

Në kuadër të kësaj vizite, homologu turk u prit edhe nga ministri i Mbrojtjes, Ermal Nufi, i cili theksoi rëndësinë e forcimit të partneritetit strategjik dhe zgjerimit të bashkëpunimit konkret mes dy vendeve aleate.


Gjatë këtij takimi u vu theksi në rritjen e kapaciteteve përmes edukimit ushtarak dhe intensifikimit të stërvitjeve të përbashkëta, me synim rritjen e ndërveprueshmërisë dhe gatishmërisë operacionale. Ministri Ermal Nufi shprehu gjithashtu mirënjohje për mbështetjen e vazhdueshme të Turqisë në modernizimin dhe fuqizimin e Forcave të Armatosura shqiptare.

Kjo vizitë e nivelit të lartë dëshmon qartë se marrëdhëniet Shqipëri-Turqi mbeten një model bashkëpunimi të suksesshëm në fushën e mbrojtjes, duke kontribuar drejtpërdrejt në forcimin e sigurisë rajonale dhe në rritjen e kapaciteteve të përbashkëta në kuadër të aleancës.

Një partneritet i fortë dhe në zhvillim, në shërbim të paqes, sigurisë dhe stabilitetit.



Vizita e nivelit të lartë nga Turqia forcon partneritetin strategjik në mbrojtje



Kursantët e Kursit të Lartë të Oficerit zhvillojnë vizitë studimore në NATO dhe institucionet e BE-së

Kursantët e Kursit të Lartë të Oficerit (KLO) kanë zhvilluar një vizitë studimore në SHAPE, në Belgjikë, si dhe në institucione të rëndësishme të Bashkimit Evropian, në kuadër të programit të tyre të formimit profesional dhe akademik.

Gjatë vizitës në SHAPE, kursantët u njohën nga afër me rolin thelbësor të këtij institucioni në kuadër të NATO-s. Ata u informuan mbi funksionet kryesore në planifikimin, përgatitjen, zhvillimin dhe ekzekutimin e operacioneve, misioneve dhe detyrave ushtarake të Aleancës. Një vëmendje e veçantë iu kushtua sfidave aktuale të sigurisë me të cilat përballlet NATO në mjedisin strategjik global.

Në vijim, kursantët zhvilluan vizitë edhe në Kolegjin e Sigurisë dhe Mbrojtjes të Bashkimit Evropian, ku u pritën nga stafi i institucionit dhe u njohën me misionin, aktivitetet dhe rolin e tij në kuadër të Politikës së Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes së BE-së. Gjatë takimeve u trajtuan edhe sfidat e reja të sigurisë në Evropë dhe më gjerë, në kontekstin e zhvillimeve të fundit globale.

Një takim i veçantë u zhvillua mes Komandantit të Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, Altin Kurti, dhe Drejtorit të Kolegjit të Sigurisë dhe Mbrojtjes së BE-së, z. Fergal Ó Regan, ku u diskutua mbi mundësitë e bashkëpunimit ndërinstitucional në të ardhmen. Programi i vizitës në Bruksel u koordinua nga Departamenti i Udhëheqjes Ushtarake dhe Departamenti i Strategjisë dhe Studimeve të Avancuara, nën drejtimin e Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë.

Paralelisht, kursantët zhvilluan një vizitë edhe në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë, ku u pritën nga përfaqësues të lartë të drejtorive përkatëse. Gjatë takimit ndërveprues, ata u njohën me rolin e kësaj ministrie në politikën e jashtme dhe në sigurinë kombëtare. Këto aktivitete përbëjnë një hap të rëndësishëm në forcimin e formimit profesional të kursantëve dhe në thellimin e bashkëpunimit ndërinstitucional në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Një investim i rëndësishëm në përgatitjen e lidershit ushtarak të së ardhmes.



“Siguria Operative-26”: Policia Ushtarake rrit gatishmërinë në stërvitjen njëjavore në Pashaliman

Në zbatim të Planëzimit Vjetor për vitin 2026, Policia Ushtarake ka zhvilluar një stërvitje njëjavore në ambientet e BD Pashaliman, në nivel toge operacionale, me pjesëmarrjen e efektivëve të Kompanisë së Dytë Operacionale.

Stërvitja me emërtimin “Siguria Operative-26” kishte për qëllim rritjen e nivelit të gatishmërisë dhe përforcimin e aftësive operacionale të personelit, në përputhje me detyrat dhe misionin e Policisë Ushtarake.

Gjatë zhvillimit të aktivitetit stërvitor, efektivët realizuan një sërë detyrash operacionale, përfshirë shoqërimet, ndërhyrjet në objekte të ndryshme, si dhe ngritjen dhe funksionimin e pikave të kontrollit. Këto skenarë u zhvilluan në kushte të ngjashme me situata reale, duke synuar rritjen e reagimit të shpejtë dhe efektiv.


Në tërësi, stërvitja u karakterizua nga disiplinë e lartë, koordinim i mirë mes strukturave dhe profesionalizëm në ekzekutimin e detyrave të ngarkuara.

“Siguria Operative-26” vlerësohet si një hap i rëndësishëm në përmirësimin e kapaciteteve operacionale të Policisë Ushtarake dhe në forcimin e aftësisë së saj për përmbushjen e misioneve të sigurisë.

Një tjetër dëshmi e rritjes së standardeve profesionale në strukturat e Policisë Ushtarake.



Lamtumirë kolosit të mendimit, REXHEP QOSJA në përjetësi



Një mendje e madhe ndalet: Rexhep Qosja lë pas një trashëgimi të pavdekshme

Ndarja nga jeta e akademikut Rexhep Qosja shënon një nga humbjet më të mëdha për kulturën, shkencën dhe ndërgjegjen kombëtare shqiptare. Studiues, shkrimtar, kritik letrar dhe intelektual i përmasave mbarëkombëtare, ai ishte një prej figurave më të rëndësishme të mendimit shqiptar në shekujt XX dhe XXI. Me ikjen e tij, nuk shuhet vetëm një jetë e gjatë dhe e pasur, por mbyllet një epokë e të menduarit kritik, e guximit intelektual dhe e përkushtimit ndaj çështjes kombëtare.

Një jetë në shërbim të dijes dhe kombit

I lindur më 25 qershor 1936, në Vuthaj, të Malit të Zi, Rexhep Qosja e nisi rrugën e tij arsimore në vendlindje dhe në Guci, për ta vazhduar më pas në Prishtinë, ku përfundoi Shkollën Normale në vitin 1959. Një vit më vonë u regjistrua në Degën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Fakultetin Filozofik të Prishtinës, ku u diplomua në vitin 1964, duke shënuar fillimin e një karriere të jashtëzakonshme akademike.

Angazhimi i tij në Institutin Albanologjik të Prishtinës, ku u pranua si asistent në vitin 1967, do të shndërrohej në një bosht qendror të veprimtarisë së tij shkencore. Pas specializimit në Universitetin e Beogradit dhe mbrojtjes së doktoratës në vitin 1971 mbi jetën dhe veprën e Asdrenit, ai u ngrit në nivelet më të larta akademike, duke u bërë një nga figurat udhëheqëse të studimeve albanologjike.

Si drejtor i Institutit Albanologjik për disa mandate dhe profesor në Fakultetin Filozofik të Prishtinës, Qosja ndikoi drejtpërdrejt në formimin e brezave të tërë studiuesish, duke lënë gjurmë të pashlyeshme në jetën akademike shqiptare.

Mendimtar i guximshëm dhe zë i ndërgjegjes

Pa asnjë hezitim, Rexhep Qosja i përket panteonit të mendimit dhe vetëdijes kombëtare shqiptare. Misioni i tij ishte i qartë: të thoshte të vërtetën, ta mbronte atë dhe të kërkonte zgjidhje, edhe kur kjo kërkonte guxim përballë kohës dhe rrymave.

Ai ishte modeli i antikonformizmit, mendimtari që nuk përkulet dhe idealisti që nuk dorëzohet. Në një kohë kur kompromisi shpesh shitej si mençuri, Qosja zgjodhi të mbetet i drejtë, kritik dhe i pakompromis ndaj padrejtësisë dhe hipokrizisë.

Një nga momentet më domethënëse të guximit të tij intelektual ishte ballafaqimi i vitit 1988 në Beograd mes akademive të Kosovës dhe Serbisë. Aty, fjala e tij u shndërrua në argument dhe kufi, një moment kur mendimi triumfoi mbi presionin politik.

Krijimtaria që formësoi ndërgjegjen

Vepra e Rexhep Qoses është e gjerë dhe e shumëllojshme, duke përfshirë kritikë letrare, histori të letërsisë, romane, ese dhe publicistikë. Ai është autor i mbi tridhjetë librave, të cilët kanë ndikuar thellë në

mendimin shqiptar. Romani “Vdekja më vjen prej syve të tillë” u bë një fenomen i vërtetë kulturor në vitet ’80, sidomos në mesin e rinisë studentore në Shqipëri. Ai lexohej me një frymë, si një dëshmi e fuqisë së fjalës që depërton aty ku lind ndërgjegjja.

Ndërsa vepra “Zgjidhja e çështjes kombëtare shqiptare” mbetet një testament politik dhe intelektual, një udhërrëfyes për shqiptarët në kohë të vështira dhe të ndërlikuara.

Ai nuk i shërbeu rehatisë së mendimit, por sfidës së tij. Shkrimet e tij nuk ishin vetëm analiza, ato ishin thirrje për reflektim, për reagim dhe për përgjegjësi.

Një figurë përtej kohës

Rexhep Qosja do të kujtohet si një “Diogjen shqiptar”, një kërkues i së vërtetës në dritën e ditës, i pamëshirshëm ndaj hipokrizisë dhe i përkushtuar ndaj arsyes dhe dinjitetit.

Ai ishte një intelektual që nuk u mjaftua me interpretimin e botës, por kërkoi ta ndryshojë atë përmes mendimit dhe fjalës.

Përveç veprimtarisë shkencore dhe letrare, ai ishte i angazhuar edhe në jetën politike, duke drejtuar një parti në periudhën 1998–2000. Ky angazhim dëshmon për dimensionin e tij si intelektual aktiv dhe i përgjegjshëm ndaj fatit të kombit.

Trashëgimi

Për kontributin e tij të jashtëzakonshëm, ai u nderua me çmime të shumta, ndër to edhe titulli “Nderi i Kombit” nga Republika e Shqipërisë. Veprat e tij janë përkthyer në disa gjuhë dhe vazhdojnë të jenë objekt studimi në qarqe akademike.

Si anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, ai ishte një figurë kyçe në zhvillimin e mendimit shkencor shqiptar.

Një humbje e madhe, një trashëgimi e përjetshme

Sot, ndërsa ai u nda nga jeta në moshën 90-vjeçare, shqiptarët humbasin një nga mendjet më prodhimtare dhe më të guximshme të tyre. Por trashëgimia që ai lë pas është e pamashë.

Ai mbetet një nga mendimtarët më të rëndësishëm shqiptarë, një mbrojtës i palodhur i identitetit kulturor dhe një zë i fuqishëm në debatet kombëtare.

Ministria e Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë. Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dhe mbarë bota shqiptare e përkujtojnë si një personalitet të pazëvendësueshëm, një mendje të ndritur dhe një figurë që do të jetojë gjatë në kujtesën kolektive.

Emri dhe vepra e tij do të mbeten të gjalla në historinë e kulturës shqiptare.

I përjetshëm qoftë kujtimi i tij!

KRAHËTESHQIPËRISË:

Nga ëndrra në forcë ajrore moderne



Historia e Aviacionit Ushtarak Shqiptar është një nga rrëfimet më domethënëse të përpjekjeve të shtetit shqiptar për të ndërtuar kapacitete moderne mbrojtëse në kushte shpeshherë të vështira. Nga përpjekjet e para modeste në vitet '20, deri te një forcë ajrore e integruar në strukturat e NATO-s, ky rrugëtim përfaqëson vullnetin, sakrificën dhe profesionalizmin e brezave të tërë ushtarakësh.

Përpjekjet e para për krijimin e aviacionit ushtarak datojnë që në fillim të shekullit XX. Megjithatë, mungesa e burimeve financiare dhe infrastrukturore bëri që këto nisma të mbeteshin në nivel projektesh. Edhe pse në vitet '20 dhe '30 u hartuan ligje për organizimin e forcave ajrore, ato nuk arritën të funksionalizoheshin.

Një kthesë vendimtare erdhi pas Luftës së Dytë Botërore. Në prill të vitit 1945 u krijua Seksioni i Aeronautikës pranë Shtabit të Përgjithshëm, duke hedhur themelet e para konkrete. Kulmi i këtij procesi u arrit, më 24 prill 1951, kur u krijuan zyrtarisht Forcat Ajrore të Ushtrisë Shqiptare, me ardhjen e avionëve të parë luftarakë dhe formimin e repartit të parë në Laprakë.

Ndërtimi në kushte sfiduese dhe epoka e avionëve reaktivë

Aviacioni shqiptar u ngrit në kushte tepër të vështira: pa traditë, pa bazë teknike dhe me mungesa të theksuara logjistike. Megjithatë, përkushtimi i kuadrove dhe mbështetja ndërkombëtare e kohës mundësuan ndërtimin e një strukture funksionale.

Vitet 1954–1955 shënuan hyrjen e avionëve reaktivë, duke hapur një epokë të re për aviacionin shqiptar. Pilotët

AVIACIONI USHTARAK SHQIPTAR

Një Shekull Sfidë, Sakrificë, Krenari

Nga përpjekjet e para tek një forcë moderne në NATO





tanë përvetësuan shpejt teknologjinë moderne dhe arritën standarde të krahasueshme me vendet e tjera të kohës. Në vitin 1959, aviacioni u pajis me avionë supersonikë dhe raketa ajër-ajër, duke rritur ndjeshëm aftësitë mbrojtëse.

Sfidat e izolimit dhe qëndrueshmëria profesionale

Pas prishjes së marrëdhënieve me Traktatin e Varshavës, aviacioni shqiptar u përball me një krizë të thellë furnizimesh dhe mbështetjeje teknike. Megjithatë, falë profesionalizmit dhe përkushtimit të personelit, u arrit të ruhej funksionaliteti dhe gatishmëria luftarake.

Në këtë periudhë u ndërtuan baza të fortifikuara, u krijuan regjimente dhe u zhvilluan kapacitete vendase për mirëmbajtje dhe riparim. Aviacioni shqiptar mbijetoi dhe vijoi të jetë një faktor kyç në mbrojtjen e hapësirës ajrore.

Modernizimi pas viteve 2000 dhe integrimi në NATO

Pas viteve '90 dhe veçanërisht pas vitit 2000, Forcat Ajrore hynë në një fazë të re modernizimi. Filloi pajisja me teknikë perëndimore, duke përfshirë helikopterë modernë si AB-206, AB-205, A-109, BO-105, EC-145 dhe “Cougar”. Këto investime rritën ndjeshëm kapacitetet operacionale dhe ndërveprimin me aleatët.

Integrimi në NATO solli standarde të reja në trajnim, organizim dhe operacione, duke e transformuar Forcën Ajrore në një strukturë bashkëkohore dhe të besueshme.



Kontributi përtej mbrojtjes

Aviacioni shqiptar ka luajtur një rol të rëndësishëm edhe në jetën civile. Ai ka qenë i pranishëm në operacione shpëtimi, në përballimin e fatkeqësive natyrore, si dhe në

mbështetje të zhvillimit ekonomik të vendit.

Ky dimension human e bën aviacionin jo vetëm një forcë ushtarake, por edhe një aset të rëndësishëm kombëtar në shërbim të qytetarëve.

Drejtuesit dhe figurat kryesore

Në ndërtimin dhe drejtimin e aviacionit shqiptar kanë kontribuar një sërë komandantësh dhe drejtuesish të shquar. Komandanti i parë ishte Edip Ohri, i cili vendosi themelet e organizimit të kësaj arme. Pas tij, drejtimi u vijua nga figura si Bardhyl Taçi, Klement Aliko dhe Perlat Binaj.

Në periudhën e tranzicionit dhe më pas, drejtimin e Forcave Ajrore e kanë mbajtur drejtues si Edmond Zhupani, Muharrem Kuçana, Kudret Çela, Astrit Jaupi, Vladimir Avdiaj, Ylli Pulaj, Ferdinand Dimo dhe së fundmi Edmond Voci.

Krahas tyre, një kontribut të rëndësishëm kanë dhënë edhe dhjetëra kuadro të tjerë të shquar të ushtrisë shqiptare, të cilët kanë ndërtuar dhe konsoliduar këtë armë ndër vite.



Heroizmi dhe sakrifica

Historia e aviacionit shqiptar është e lidhur ngushtë me sakrificën. Plot 43 ushtarakë të kësaj arme kanë rënë në krye të detyrës dhe janë shpallur “Dëshmorë të Atdheut”. Ata prehen në Varrezat e Dëshmorëve të Kombit, duke mbetur simbol i përjetshëm i përkushtimit ndaj vendit.

Ndërkohë, brezat e parë të pilotëve dhe teknikëve hodhën themelet e një tradite që vazhdon edhe sot, duke frymëzuar generatat e reja.

Trashëgimia dhe e ardhmja

Sot, Aviacioni Ushtarak Shqiptar është një pjesë integrale e strukturave të mbrojtjes euro-atlantike. Ai vazhdon të modernizohet, duke investuar në teknologji dhe në përgatitjen e personelit.

Trashëgimia e së kaluarës mbetet një burim krenarie dhe frymëzimi. Aviacioni shqiptar është dëshmi se përkushtimi, profesionalizmi dhe sakrifica mund të ndërtojnë institucione të forta edhe në kushtet më sfiduese.

Aviacioni ushtarak shqiptar nuk është vetëm një armë e Forcave të Armatosura. Ai është simbol i vullnetit të një kombi për të mbrojtur lirinë dhe sovranitetin e tij. Një histori që vazhdon të shkruhet çdo ditë në qiellin shqiptar, me përkushtim, dinjitet dhe krenari.



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Çdo 23 prill, në kuadër të Ditës Botërore të Librit dhe e të Drejtës së Autorit, rikthehet në vëmendje një pyetje thelbësore: çfarë vendi zë libri në jetën tonë sot?

Nëse dikur leximi ishte një nga aktivitetet më të natyrshme dhe më të përhapura në shoqërinë shqiptare, sot ai përballlet me një tkurrje të dukshme, që nuk mund të shpjegohet vetëm me ndryshimet teknologjike. Fenomeni i rënies së leximit është kompleks dhe kërkon një analizë më të thellë, që shkon përtej nostalgjisë për të kaluarën.

Historikisht, libri në Shqipëri ka pasur një rol të veçantë. Në periudha të ndryshme, ai ka qenë jo vetëm burim njohurie, por edhe mjet formimi identitar dhe rezistence kulturore. Në mungesë të institucioneve të konsoliduara, libri ka mbajtur peshën e edukimit dhe të ndërgjegjësimit shoqëror. Pikërisht për këtë arsye, rënia e leximit sot nuk është thjesht një ndryshim zakoni, por një transformim që prek vetë strukturën kulturore të shoqërisë.

Një nga faktorët më të dukshëm është kalimi nga kultura e librit te kultura e ekranit. Teknologjia ka sjellë një revolucion në mënyrën e marrjes së informacionit. Përmbajtjet e shkurtra, videot, rrjetet sociale dhe informacioni i menjëhershëm kanë krijuar një model të ri konsumimi, ku thellësia shpesh sakrifikohet për shpejtësinë. Leximi i një libri kërkon përqendrim të zgjatur, durim dhe një angazhim aktiv mendor – cilësi që bien ndesh me ritmin e shpejtë të botës digjitale. Kjo nuk do të thotë se teknologjia është armiku i librit, por se ajo ka ndryshuar rregullat e lojës pa u shoqëruar me një edukim të ri për përdorimin e saj.

Megjithatë, reduktimi i fenomenit vetëm te teknologjia do të ishte një analizë e cunguar. Sistemi arsimor ka një përgjegjësi të rëndësishme në këtë drejtim. Në shumë raste, leximi trajtohet si detyrim formal dhe jo si përvojë personale. Programet mësimore shpesh nuk arrijnë të krijojnë lidhje emocionale mes nxënësit dhe librit. Kur leximi kufizohet në analiza mekanike dhe detyra të detyruara, ai humbet dimensionin e tij krijues dhe shndërrohet në një aktivitet të padëshiruar. Kjo krijon një distancë që vazhdon edhe në jetën e rritur.

Një tjetër element është dobësia e ekosistemit të librit. Tregu botues në Shqipëri përballlet me sfida të shumta, tirazhe të ulëta, shpërndarje të kufizuar, mungesë mbështetjeje institucionale dhe konkurrencë të fortë nga përmbajtjet falas online. Bibliotekat publike, që duhet të jenë qendra të gjalla të kulturës, shpesh mbeten të pazhvilluara dhe të pa integruara në jetën komunitare. Pa një infrastrukturë të fortë kulturore, libri mbetet një produkt i izoluar dhe jo një pjesë organike e përditshmërisë.

Dimensioni ekonomik është po ashtu i rëndësishëm. Në një realitet ku shumë familje përballen me vështirësi financiare, libri shpesh nuk konsiderohet prioritet. Kjo nuk lidhet vetëm me çmimin, por edhe me perceptimin e vlerës. Nëse libri nuk shihet si investim afatgjatë në dije dhe zhvillim personal, ai zëvendësohet lehtësisht nga forma të tjera më të lira ose më të aksesueshme të argëtimit.

Por ndoshta problemi më i thellë është ai i kulturës së leximit si praktikë sociale. Leximi nuk lind në vakum, ai kultivohet në familje dhe në komunitet. Kur fëmijët rriten në

Nga kultura e librit te kultura e ekranit: A po humbet Shqipëria aftësinë për të lexuar?



Diskursi publik në Shqipëri rrallëherë e vendos librin në qendër. Debatet dominohen nga çështje të menjëhershme dhe sensacionale, ndërsa kultura e leximit mbetet në periferi. Në mungesë të një promovimi të vazhdueshëm dhe serioz, libri nuk arrin të krijojë atë status simbolik që do ta bënte pjesë të aspiratës shoqërore.

ambiente ku libri nuk është i pranishëm, ku nuk ka modele leximi dhe ku diskutimi mbi librat mungon, është e vështirë që ata ta zhvillojnë këtë zakon në mënyrë të natyrshme. Në këtë kuptim, rënia e leximit është edhe pasojë e një shkëputjeje ndër breza në transmetimin e vlerave kulturore.

Një aspekt që shpesh anashkalohet është ndikimi i medias dhe hapësirës publike. Diskursi publik në Shqipëri rrallëherë e vendos librin në qendër. Debatet dominohen nga çështje të menjëhershme dhe sensacionale, ndërsa kultura e leximit mbetet në periferi. Në mungesë të një promovimi të vazhdueshëm dhe serioz, libri nuk arrin të krijojë atë status simbolik që do ta bënte pjesë të aspiratës shoqërore.

Megjithatë, pavarësisht kësaj tabloje, nuk duhet rënë në fatalizëm. Historia tregon se zakonet kulturore mund të ndryshojnë dhe të rigjallërohen. Për të ndodhur kjo, nevojitet një qasje e shumanshme. Arsimi duhet të reformojë mënyrën se si prezantohet leximi, duke e bërë atë më të lidhur me përvojën personale të nxënësit. Institucionet duhet të investojnë në biblioteka moderne dhe në programe që e

afrojnë librin me komunitetin. Botuesit dhe autorët duhet të gjejnë forma të reja për të arritur te lexuesi, duke shfrytëzuar edhe potencialin e teknologjisë.

Mbi të gjitha, nevojitet një ndryshim në mënyrën se si shoqëria e percepton leximin. Ai nuk duhet parë si aktivitet elitist apo i kufizuar, por si një nevojë themelore për zhvillimin intelektual dhe emocional. Në një botë të mbushur me informacion të shpejtë dhe shpesh sipërfaqësor, libri mbetet një nga mjetet e pakta që ofron thellësi, reflektim dhe kuptim.

Rënia e leximit nuk është thjesht humbje e një zakoni, por rrezik për varfërimin e mendimit.

Një shoqëri që lexon më pak, mendon më pak thellë. Rikthimi te libri nuk kërkon vetëm politika apo fushata, por një zgjedhje të vetëdijshme nga secili prej nesh. Sepse çdo libër i hapur është një dritare e re dhe çdo dritare e mbyllur është një mundësi e humbur për të kuptuar më mirë botën dhe veten.

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

“GEGNISHT” APO “TOSKËRISHT”?!

Edhe pse jam toskë, do të thosha me zë të lartë: Gegnisht, sepse Gegnishtja nuk është një dialekt, është vetë Shqipja jonë në të gjitha dimensionet e saj.

Gjuha e një kombi i vendos vetë tendencat e saj. Ndërsa një akademik, që flet vetëm gegnisht dhe nuk di të flasë po aq mirë edhe toskërisht, nuk ka tagër të propozojë ndryshime radikale në standard.

Sa për referendumin se cili dialekt duhet të dominojë variantin zyrtar të shqipes, kjo është një rrugë e rrezikshme për shqiptarët në të gjitha trojet etnike. Kushtetuta e gjuhës nuk është si kushtetuta e shtetit, nuk buron nga sistemet politike, por nga vetëdija kulturore e gjallë e popullit. Gjuha është e gjallë, si deti, si pylli, si lumi, si ajri që lëviz.

Ka momente në jetën e një kombi kur debatet që duken gjuhësore, në thelb janë shumë më tepër se kaq, janë debate për identitetin, për kujtesën, për mënyrën se si e shohim veten dhe për drejtimin që duam të marrim si shoqëri. I tillë është edhe diskutimi i rikthyer me forcë mbi gegnishten dhe toskërishten.

Në sipërfaqe, duket si një përplasje dialektesh. Në thelb, është një përplasje narrativash, midis shkencës dhe mitit, midis kujtesës historike dhe interpretimeve të saj, midis nevojës për unitet dhe tundimit për ndarje.

Në këtë debat shpesh dëgjojmë zëra të fortë që shpallin të vërteta absolute. Disa e ngrenë gegnishten në rangun e “protoshqipes”, madje deri në pretendime se ajo është burimi i gjuhëve indoevropiane.

Këto pohime, sado të ngarkuara me pathos patriotik, nuk i qëndrojnë analizës së gjuhësisë historike. Në këtë disiplinë, koncepti i proto-gjuhës është i qartë, një fazë e rindërtuar teorikisht, shumë më e hershme se çdo dialekt i dokumentuar. Gegnishtja, ashtu si toskërishtja, është një zhvillim i mëvonshëm i shqipes, dhe jo burimi i saj fillestar.

Të thuash këtë nuk është të zvogëlosh gegnishten, përkundrazi, është ta vendosësh atë në vendin që i takon realisht, një nga shtyllat më të fuqishme të identitetit gjuhësor shqiptar, një pasuri e jashtëzakonshme letrare dhe kulturore, një mënyrë e gjallë dhe autentike e të shprehurit. Por kjo vlerë nuk ka nevojë për mitologji, ajo qëndron vetë.

Nëse i referohemi punës së studiuesve si Eqerem Çabej, Shaban Demiraj apo Mahir Domi, bëhet e qartë se gegnishtja dhe toskërishtja janë dy degë të një trungu të përbashkët. Nuk kemi të bëjmë me një marrëdhënie ku njëra lind tjetrën, por me një evolucion paralel, të kushtëzuar nga faktorë historikë, gjeografikë dhe shoqërorë.

Dhe pikërisht këtu fillon problemi i vërtetë: kur debati shpëputet nga kjo bazë shkencore dhe rrëshqet në territore emocionale, ku argumenti zëvendësohet nga bindja, dhe bindja nga retorika.

Në këtë kontekst, është e pamundur të shmanget standardi i shqipes, i kodifikuar nga Kongresi i Drejtshkrimit i vitit 1972. Ai përfaqëson një nga ndërhyrjet më të rëndësishme në historinë tonë gjuhësore.

Po, ai u ndikua nga politika e kohës. Po, ai mbështeti më fort toskërishten. Por mbi të gjitha, ai krijoi një realitet të ri, një gjuhë të përbashkët funksionale për një komb që kishte nevojë urgjente për unitet.

Sot, pas më shumë se gjysmë shekulli, është e lehtë të kritikosh atë proces. Por duhet të jemi të ndershëm,



GEGNISHTJA APO TOSKËRISHTJA?

Midis pasionit identitar dhe së vërtetës shkencore

pa atë standard, Shqipja nuk do të kishte arritur nivelin e institucionalizimit që ka sot. Arsimi, administrata, botimet, media të gjitha do të ishin shumë më të fragmentuara.

Megjithatë, kjo nuk do të thotë se standardi është i përsosur, asnjë gjuhë standarde nuk është.

Gjuha nuk është monument, është organizëm i gjallë dhe si çdo organizëm, ajo ndryshon, përshtatet, sfidohet.

Sot, sfidat janë reale dhe të dukshme. Nga njëra anë, kemi një vërshim të pakontrolluar huazimesh, sidomos nga anglishtja. Nga ana tjetër, një rënie alarmante të normës drejtshkrimore, fjalët që deformohen, struktura që shpërbëhen këto nuk janë probleme dialektesh. Janë probleme kulture gjuhësore.

Në këtë klimë, kërkesa për të “shpëtuar” shqipen duke përmbysur standardin tingëllon paradoksale. Nuk është standardi që po e dëmton gjuhën. Është shpërdorimi i saj.

Por ndoshta problemi më i madh i debatit aktual nuk është as shkencor, as teknik. Është etik dhe kulturor.

Po krijohet një klimë ku kushdo ndjen të drejtën të flasë për gjuhën me autoritet absolut, pa pasur bazën minimale të dijes.

Ku shpifja paraqitet si kritikë, dhe zhurma si argument. Ku patriotizmi përdoret si mburojë për injorancën.

Gjuha nuk mbrohet me britma. Mbrohet me dije.

Dhe në këtë pikë, përgjegjësia bie mbi institucionet që dikur e mbanin gjallë këtë dije: universitetet, institutet kërkimore, akademitë. Emra si Selman Riza apo Emil Lafa

përfaqësonin një standard jo vetëm shkencor, por edhe moral. Sot, kjo trashëgimi duket e zbehur.

E megjithatë, përtej gjithë këtij zhurmimi, një e vërtetë mbetet e pandryshuar: Shqiptarët merren vesh.

Merren vesh në gegnisht, në toskërisht, në të gjitha nuancat e ndërmjetme. Kjo është prova më e fortë se gjuha jonë, pavarësisht dallimeve, është një.

Dhe ndoshta pikërisht këtu duhet të kthehemi. Jo tek pyetja “cili dialekt është më i vjetër” Jo tek gara “kush është më autentik” Por te përgjegjësia: si ta ruajmë këtë pasuri?

Rilindësit tanë nuk patën luksin të merren me këto ndarje. Ata kishin një mision: ta shpëtonin gjuhën. Dhe e bënë këtë pa e ndarë në gegë e në toskë. Ata e panë shqipen si një trup të vetëm, një identitet të përbashkët.

Sot, ne kemi luksin të debatojmë. Por nuk duhet të harrojmë përgjegjësinë që vjen me këtë luks.

Gegnishtja nuk është armike e toskërishtes. Toskërishtja nuk është kërcënim për gegnishten. Standardi nuk është burg për asnjërën.

Të tria janë pjesë e së njëjtës histori. Dhe nëse ka një betejë që ia vlen të bëhet sot, nuk është ajo për dominim dialektesh. Është ajo për cilësinë e gjuhës sonë. Për pastërtinë, për saktësinë, për dinjitetin e saj.

Sepse, gjuha nuk është thjesht mjet komunikimi. Ajo është mënyra se si ekzistojmë si komb...

KULLA ENGUGJIMIT NË THETH

Një plagë e hapur e historisë shqiptare që ende flet

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Në jug të Thethit, pranë ujërave të kristalta të Lumit të Shalës, ngrihet një kullë e heshtur, e fortë, e palëvizshme në kohë. Kulla e Ngujimit nuk është thjesht një ndërtesë e vjetër prej guri; ajo është një arkiv i gjallë i një realiteti që për shumëkënd duket i largët, por që për disa familje shqiptare mbetet ende i pranishëm.

E ndërtuar rreth 400 vite më parë, kjo kullë trekatëshe shërbente si strehë për burrat dhe djemtë mbi moshën 14 vjeç që detyroheshin të ngujoheshin për shkak të gjakmarrjes. Muret e saj të trasha nuk ishin luks, por mburojë. Dritaret e ngushta nuk ishin për pamje, por për mbijetesë. Brenda tyre, jeta nuk rridhte ajo ndalej.

Ky fenomen nuk mund të kuptohet pa referencën ndaj Kanunit të Lekë Dukagjinit, një sistem normash zakonore që për shekuj ka rregulluar jetën në veri të Shqipërisë. Brenda këtij kodi, gjakmarrja ishte një mekanizëm “drejtësie”, i lidhur me nderin, me fisin dhe me detyrimin për hakmarrje. Por ajo që në teori paraqitej si ekuilibër moral, në praktikë prodhonte cikle të pafundme dhune dhe izolimi.

Dhe pikërisht këtu qëndron thelbi i tragjedisë, gjakmarrja nuk vriste vetëm një herë ajo vriste çdo ditë.

Sot, Kulla e Ngujimit është e vizitueshme. Turistët ndalen, dëgjojnë histori dhe fotografojnë një të shkuar që duket e largët. Por jashtë itinerareve turistike, në disa zona të veriut shqiptar, realiteti i ngujimit nuk është thjesht histori.

Ende sot, familje të tëra jetojnë të mbyllura në shtëpitë e tyre, për shkak të konflikteve të gjakut. Burra dhe djem nuk dalin nga dera për vite me radhë. Fëmijë që duhet të jenë në shkollë, rriten brenda katër mureve. Dritaret bëhen kufij, dhe oborri një territor i ndaluar.

Ky nuk është më Kanuni në formën e tij tradicionale. Është një deformim i tij.

Sepse në interpretimin klasik, Kanuni vendoste kufij dhe rregulla, kishte ndërmjetësim, kishte besë, kishte mekanizma për të shmangur përshkallëzimin.

Sot, shpesh kemi të bëjmë me një version të çrregullt, ku hakmarrja ushqehet nga mungesa e besimit të drejtësisë institucionale dhe nga një kulturë e deformuar e nderit.

Pasojat janë të rënda dhe shumëdimensionale:

Sociale: Familjet izoloohen, humbin lidhjet me komunitetin, jetojnë në frikë të vazhdueshme. **Arsimorë:** Fëmijët ndërpresin shkollimin, duke krijuar një brez të rrezikuar nga marginalizimi.

Psikologjike: Trauma, ankthi dhe ndjenja e pasigurisë bëhen pjesë e përditshme e jetës.

Ekonomike: Pamundësia për të punuar e thëllon varfërinë dhe varësinë.

Në këtë kontekst, ngujimi nuk është vetëm një akt mbrojtjeje; është një formë e heshtur burgimi, pa gjyq dhe pa afat.

Kulla e Ngujimit në Theth bëhet kështu një metaforë e fuqishme, një ndërtesë që dikur mblidhte njerëzit për t'i



mbrojtur, sot na kujton se sa pak duhet që një shoqëri të rrëshqasë drejt izolimit dhe dhunës, kur ligji zëvendësohet nga zakoni dhe kur drejtësia delegohet te individi.

Dhe pyetja që lind është e drejtpërdrejtë: **si është e mundur që në shekullin XXI, në një shoqëri që synon integrimin europian, ende ekzistojnë familje të ngujuara?**

Përgjigjja nuk është e thjeshtë. Mungesën e ndërhyrjeve efektive sociale, trashëgiminë kulturore të pa adresuar siç duhet, dhe heshtjen kolektive që shpesh e shoqëron këtë fenomen.

Megjithatë, ka edhe përpjekje për ndryshim. Organizata të ndryshme, ndërmjetës komunitarë dhe institucione shtetërore kanë ndërhyrë për pajtime, për rikthimin e fëmijëve në shkollë dhe për integrimin e familjeve të izoluara. Por këto përpjekje mbeten të pjesshme dhe shpesh të fragmentuara.

Kulla e Ngujimit nuk është më funksionale si dikur. Ajo nuk strehon më burra të mbyllur brenda. Por në një mënyrë simbolike, ajo vazhdon të ekzistojë në shtëpitë ku dritaret nuk hapen, në rrugët që nuk shkelën, në jetët që presin.

Ajo që dikur ishte një ndërtesë prej guri, sot është një realitet i shpërndarë.

Dhe pikërisht për këtë arsye, kjo kullë duhet parë jo vetëm si atraksion turistik, por si një pikë reflektimi kombëtar. Ajo na fton të përballemi me të shkuarën, por edhe të marrim përgjegjësi për të tashmen.

Sepse një shoqëri që lejon izolimin e fëmijëve dhe burgosjen e jetëve për shkak të gjakut, nuk ka përfunduar ende rrugëtimin e saj drejt qytetërimit të plotë.

Kulla e Ngujimit duhet të mbetet vetëm histori. Jo realitet.

Dhe kjo nuk është vetëm detyrë e shtetit. Është përgjegjësi e të gjithëve.



“Kolonelet e nderit” që ngrenë lart flamurin kuqezi – Briken Calja dhe Distria Krasniqi shkëlqejnë në arenën europiane

Forcat e Armatosura shqiptare dhe hapësira mbarëkombëtare kanë arsye të ndihen krenarë, teksa dy prej figurave më të spikatura të sportit, të nderuar edhe me titullin “kolonel nderi”, vijnë në lartësojnë flamurin kombëtar në arenën ndërkombëtare.

Në Batumi, aty ku u zhvillua Kampionati Europian i Peshëngritjes, Briken Calja dëshmoi edhe një herë se mosha është thjesht një numër. Në kategorinë 79 kg, shtangisti shqiptar realizoi një performancë të jashtëzakonshme, duke u shpallur kampion Europe në stilin e shtytjes me 187 kg dhe duke merituar medaljen e argjendtë në dygarësh me total 340 kg. Edhe pse e nisi garën me vendin e katërt në shkëputje, Calja reagoi me forcë dhe karakter, duke dominuar në momentin vendimtar dhe duke u ngjitur në majën e Europës.

Ky sukses i radhës konfirmon vazhdimësinë e tij si një nga figurat më të mëdha të peshëngritjes shqiptare dhe një ambasador i denjë i vendit në sportin ndërkombëtar.

Ndërkohë, në Tbilisi, një tjetër yll i sportit shqiptar, Distria Krasniqi, vazhdoi dominimin e saj në xhudo. Në Kampionatin Europian, ajo fitoi medaljen e artë në kategorinë deri në 52 kg, duke mposhtur në finale francezen Amandine Buchard. Kjo është medalja e tretë e artë radhazi në Europian për Krasniqin dhe e katërta në karrierën e saj, një arritje që e vendos atë ndër sportistët më elitare të kontinentit.

Të dy sportistët, të vlerësuar si Kolonelë nderi të Forcave të Armatosura, përfaqësojnë më së miri vlerat e përkushtimit, sakrificës dhe krenarisë kombëtare.

Arritjet e tyre nuk janë vetëm fitore sportive, por edhe një frymëzim për brezat e rinj dhe një dëshmi e potencialit shqiptar në skenën ndërkombëtare.

Në uniformë apo në arenë sportive, ata mbeten luftëtarë të denjë të flamurit kuqezi.

Krenari kombëtare dhe shembull frymëzimi për gjithë kombin.





Parlamenti i parë shqiptar: Një gur themeli në ndërtimin e shtetit dhe të institucioneve kombëtare

Në historinë e shtetit shqiptar, disa data mbeten pikë referimi për mënyrën se si një komb ndërton identitetin dhe institucionet e tij. Një prej tyre është mbledhja e parë e parlamentit shqiptar, 105 vite më parë, pas zgjedhjeve të 5 prillit – zgjedhjet e para të organizuara për një organ legjislativ në Shqipëri. Ky moment nuk përfaqësonte vetëm një zhvillim politik, por një hap të rëndësishëm drejt konsolidimit të shtetit modern shqiptar.

Vetëm nëntë vite pas Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, vendi gjendej ende përballë sfidave të shumta: konsolidimi i kufijve, ndërtimi i administratës shtetërore dhe krijimi i institucioneve funksionale. Në këtë kontekst, organizimi i zgjedhjeve dhe krijimi i një parlamenti përfaqësonte një akt të rëndësishëm politik dhe institucional, që synonte të vendoste themelet e një rendi të ri shtetëror, të bazuar mbi përfaqësimin dhe ligjshmërinë.

Zgjedhjet e 5 prillit nuk ishin thjesht një proces formal. Ato përbënin një përpjekje për të institucionalizuar vullnetin e qytetarëve dhe për të krijuar një mekanizëm vendimmarrës që do të përfaqësonte interesat e tyre. Në një kohë kur Shqipëria sapo kishte dalë nga periudha të vështira lufte dhe ndërhyrjesh të jashtme, ky zhvillim tregonte qartë aspiratën për të ndërtuar një shtet funksional dhe sovran.

Mbledhja e parë e parlamentit shënoi fillimin e një tradite parlamentare në Shqipëri. Edhe pse në rrethana të vështira politike dhe ekonomike, ky institucion u bë një hapësirë ku filluan të artikuloheshin debatet mbi drejtimin e vendit, organizimin e shtetit dhe reformat e nevojshme për zhvillimin e tij. Parlamenti nuk ishte vetëm një organ ligjvënës, por edhe një simbol i përpjekjes për të ndërtuar një kulturë politike të bazuar në dialog dhe përfaqësim.

Në këtë proces, roli i elitës politike dhe intelektuale të kohës ishte vendimtar. Ata mbartnin përgjegjësinë për të

orientuar vendin drejt një modeli shtetëror që, me gjithë vështirësitë, synonte të ishte në përputhje me parimet e shteteve moderne evropiane. Kjo përpjekje nuk ishte e lehtë, pasi Shqipëria duhej të ndërtonte nga e para institucionet e saj, shpesh në kushte të mungesës së përvojës dhe burimeve.

Për gazetën “Ushtria”, ky moment historik merr një dimension të veçantë. Ndërtimi i shtetit shqiptar ka qenë gjithmonë i lidhur ngushtë me përpjekjet për mbrojtjen e sovranitetit dhe integritetit territorial. Institucionet demokratike dhe forcat e armatosura kanë ecur paralelisht në këtë rrugëtim, të parat duke ndërtuar rendin juridik dhe politik, të dytat duke garantuar sigurinë dhe stabilitetin e vendit. Një parlament funksional dhe një ushtri e organizuar janë dy shtylla që plotësojnë njëra-tjetrën në funksion të shtetit.

Organizimi i zgjedhjeve dhe krijimi i një parlamenti përfaqësonte një akt të rëndësishëm politik dhe institucional, që synonte të vendoste themelet e një rendi të ri shtetëror, të bazuar mbi përfaqësimin dhe ligjshmërinë.

Sot, pas më shumë se një shekulli, ky moment kujtohet jo vetëm si një ngjarje historike, por si një pikënisje e një procesi që vazhdon ende. Demokracia dhe përfaqësimi nuk janë arritje të përfunduara, por procese që kërkojnë përkushtim të vazhdueshëm. Kujtimi i parlamentit të parë na rikujton se institucionet nuk ndërtohen vetëm me ligje, por me përgjegjësi, besim dhe vizion për të ardhmen.

Historia e parlamentit të parë shqiptar është histori e vullnetit për shtet, për rend dhe për përfaqësim. Ajo na mëson se ndërtimi i institucioneve është një proces i gjatë, që kërkon sakrificë dhe përkushtim. Duke e kujtuar këtë moment, ne jo vetëm nderojmë të kaluarën, por forcojmë përgjegjësinë për të mbrojtur dhe zhvilluar institucionet që garantojnë të ardhmen e vendit.

NGA RRËNJËT TE SHËRBIMI NDAJ ATDHEUT

Oxhaku “XHELILAJ” – një trashëgimi vlerash në shërbim të shtetit dhe sigurisë



PROF. ASOC. DR. ZAHO GOLEMI

Në historinë e familjeve shqiptare, ka rrëfime që nuk janë thjesht kronika brezash, por janë dëshmi të një vazhdimësie vlerash, sakrificash dhe përkushtimi ndaj atdheut. I tillë është edhe rrugëtimi i oxhakut “Xhelilaj”, një histori që nis në jugun e Shqipërisë dhe përshkon kohën përmes brezave, duke u mishëruar në shërbimin ndaj vendit.

Rrënjët e kësaj familjeje lidhen me Arrëzën e Tepelenës, një zonë me histori të hershme dhe me identitet të fortë kulturor. Prej aty, rrugëtimi familjar vijon në fshatin Zgërbonjë, lagja Vojak në Berat, më pas në Pogradec dhe përfundimisht në Tiranë, duke reflektuar lëvizjet dhe transformimet e vetë shoqërisë shqiptare ndër vite.

Sipas gojëdhënave dhe traditës së trashëguar, origjina e hershme lidhet me shpërngulje të hershme nga Kosova, si pasojë e trysnive historike. Në këtë mënyrë, rrënjët e familjes nuk janë vetëm gjeografike, por edhe historike, të ndërthurura me fatin e popullit shqiptar në shekuj.

Zona e Arrëzës, ku nis kjo histori, mbart gjurmë të hershme qytetërimi: vendbanime të lashta, objekte kulti të krishterë dhe islamë, si dhe institucione arsimore që datojnë që në shekullin XVI. Sipas dokumenteve osmane, që në vitin 1583 përmenden hane dhe një shkollë “Ruzhdije”, çka dëshmon për një jetë të organizuar dhe me tradita.

Nga tradita familjare te formimi i karakterit

Në këtë truall u formuan brezat e parë të familjes Xhelilaj, njerëz të thjeshtë, por me një etikë të fortë pune dhe me ndjenjë të lartë përkatësie. Figura të tilla si Qazim Xhelilaj (1881–1966) dhe Hurma Xhelilaj (1887–1978) përfaqësojnë themelin moral të kësaj familjeje, të njohur për respektin dhe autoritetin në komunitet.

Shpërngulja drejt Beratit, në lagjen Vojak të Zgërbonjës, sipas traditës gojore lidhet me konflikte të kohës së Ali Pashë Tepelenës, një periudhë e trazuar që ndikoi në lëvizjet e popullsisë. Megjithatë, pavarësisht vështirësive, familja ruajti kohezionin dhe vlerat e saj themelore.

Jonuz Xhelilaj – Brezi i luftës dhe i sakrificës

Një nga figurat më përfaqësuese të kësaj familjeje është Jonuz Xhelilaj, i lindur më 22 mars 1925, në Zgërbonjë të Beratit. Ai i përket atij që me të drejtë quhet “brezi i hekurt”, brezi që përjetoi luftën dhe u formua në kushte ekstreme.

Në një moshë të re, gjatë periudhës së pushtimit të Shqipërisë në vitin 1939, ai u përfshi në përpjekjet për çlirim. Në prill të vitit 1944 u rreshtua në radhët e lëvizjes antifashiste dhe më pas në formacionet partizane, duke u bërë pjesë e Brigadës VII Sulmuese, një nga njësitë më aktive të kohës. Ai u dallua për guxim dhe vendosmëri në aksione luftarake, duke u plagosur rëndë në një prej tyre. Edhe pas plagosjes, u rikthye në front dhe vijoi luftën deri në çlirimin e vendit, duke dëshmuar një përkushtim të rrallë.

Pas luftës, rruga e tij vijoi në shërbim të sigurisë kombëtare. Ai u përgatit në strukturat e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe shërbeu për më shumë se dy dekada në forcat e kufirit, në zona të ndryshme strategjike si Shkodra, Leskoviku, Qafë-Thana dhe Pogradeci. Në çdo detyrë, ai u shqua për profesionalizëm, korrektësi dhe marrëdhënie të mira me komunitetin dhe vartësit. Kontributi i tij në formimin e ushtarëve të rinj, si instruktor në Qendrën e Instruksionit në Përrenjas, mbetet një tjetër dëshmi e përkushtimit ndaj edukimit dhe disiplinës ushtarake. Për shërbimin e tij, ai u vlerësua me disa dekorata dhe tituj, duke u renditur ndër kuadrot e respektuara të kufirit shqiptar. Jonuz Xhelilaj u nda nga jeta më 3 mars 2012, duke lënë pas një trashëgimi të fortë morale dhe familjare.

Vazhdimësia e vlerave: Familja dhe brezat pasues

Në jetën familjare, Jonuzi krijoi një bashkëshortësi të qëndrueshme me Kadrije Karriqin, e cila vinte nga një



familje me tradita intelektuale dhe kontribut në komunitet. Kjo bashkim solli një brez të ri, të edukuar me vlera dhe përkushtim.

Tre djemtë e tyre, Pëllumbi, Ylli dhe Fatosi përfaqësojnë vazhdimësinë e kësaj tradite. Secili në fushën e vet ka dhënë kontribut, duke reflektuar edukimin dhe modelin familjar.

Ylli Xhelilaj – Profesionalizëm dhe integritet në Policinë e Shtetit

Një ndër figurat më të spikatura të këtij brezi është Ylli Xhelilaj, i lindur më 5 prill 1961, në Pogradec. Formimi i tij arsimor dhe profesional është i lidhur ngushtë me disiplinën dhe përkushtimin ndaj shërbimit publik.

Pas përfundimit me rezultate të larta të arsimit të mesëm në Teknikumin e Naftës në Kuçovë, ai ndoqi Shkollën e Lartë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ku u diplomua si specialist i lartë në profilin e policisë.

Karriera e tij në Policinë e Shtetit është e gjatë dhe e pasur, duke përfshirë një gamë të gjerë funksionesh, nga edukator dhe inspektor, deri në drejtues strukturash të rëndësishme të rendit publik. Ai ka shërbyer në komisarate, në Drejtorinë e Policisë së Tiranës, në strukturat qendrore dhe në Akademinë e Sigurisë.

Një nga kontributet më të rëndësishme të tij lidhet me hartimin e procedurave standarde të funksionimit për shërbimet e rendit publik, përfshirë patrullat dhe strukturat operacionale si “Shqiponjat”. Këto dokumente vijnë në jetë në fuqi dhe përbëjnë bazë për funksionimin e policimit modern.

Përgjatë karrierës, ai ka ndjekur një sërë trajnimesh kombëtare dhe ndërkombëtare në fusha si të drejtat e njeriut,

menaxhimi policor, lufta kundër trafikimit dhe korrupsionit, si dhe policimi në komunitet, duke reflektuar një qasje të vazhdueshme drejt përmirësimit profesional.

Ai është vlerësuar me certifikata dhe grada të larta, duke arritur deri në gradën “Drejtues”, si rezultat i një karriere të ndërtuar mbi meritë dhe përkushtim.

Një model shërbimi dhe përkushtimi

Ylli Xhelilaj njihet si një drejtues me integritet, korrekt dhe i përkushtuar, me aftësi të spikatura në analizë dhe menaxhim. Ai ka kontribuar jo vetëm në operacionet e përditshme të policisë, por edhe në zhvillimin institucional, përmes edukimit dhe përfshirjes në proceset akademike.

Në jetën personale, ai është një familjar i përkushtuar, duke përcjellë te brezat e rinj vlerat që ka trashëguar. Rruga e ndjekur nga djali i tij, Bruno, në strukturat e Policisë së Shtetit, është një tregues i kësaj vazhdimësie.

Një histori që vijon

Historia e familjes Xhelilaj nuk është thjesht një rrëfim gjenealogjik. Ajo është një pasqyrë e një realiteti më të gjerë shqiptar: rrënjë të thella, sfida historike dhe një përpjekje e vazhdueshme për të ndërtuar dhe mbrojtur shtetin.

Nga Arrëza e Tepelenës deri në institucionet e sigurisë moderne, kjo familje përfaqëson një vijimësi vlerash ku puna, ndershmëria dhe shërbimi ndaj atdheut mbeten boshti kryesor.

Në një kohë kur shoqëria ndryshon me ritme të shpejta, histori të tilla shërbejnë si pikë referimi: për të kuptuar nga vijnë dhe për të orientuar rrugën përpara.

Prof. Dr. Elmaz Leci

Një jetë në shërbim të dijes, *historisë* DHE SIGURISË KOMBËTARE

Me dhimbje të thellë u mësua se para disa ditësh u nda nga jeta Prof. Dr. Elmaz Leci, një figurë e shquar e mendimit akademik, historik dhe ushtarak shqiptar. Largimi i tij përbën një humbje të madhe për komunitetin shkencor, për institucionet e sigurisë dhe për gjithë ata që patën fatin ta njohin dhe të bashkëpunojnë me të.

I lindur më 10 gusht 1950, në Tiranë, Prof. Leci ia kushtoi jetën kërkimit shkencor, gazetarisë dhe edukimit të brezave të rinj. Ai ndërtoi një karrierë të pasur si studiues i historisë së Shqipërisë dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, duke u dalluar për analizat e tij të thelluara mbi periudhën e Luftës së Dytë Botërore dhe regjimin komunist.

Si pedagog, dekan dhe rektor në disa universitete, përfshirë Universitetin Ushtarak "Skënderbej", ai dha një kontribut të çmuar në formimin profesional dhe akademik të shumë studentëve në fushën e mbrojtjes, diplomacisë dhe historisë.

Në rolet drejtuese në Ministrinë e Mbrojtjes dhe si Drejtor i Institutit të Sigurisë dhe Mbrojtjes, ai ndikoi në zhvillimin e mendimit strategjik dhe në forcimin e lidhjeve euroatlantike të vendit.

Veprimtaria e tij publicistike dhe studimore është e gjerë dhe e vyer. Përmes librave dhe shkrimeve të shumta, ai solli në dritë dokumente dhe fakte të rëndësishme historike, duke kontribuar në zbardhjen e të vërtetave shpesh të debatueshme të së kaluarës shqiptare.

Prof. Leci do të kujtohet si një intelektual i përkushtuar, një studiues i palodhur dhe një qytetar që punoi me integritet për vendin e tij.

Redaksia e Shtypit Ushtarak shpreh ngushëllimet më të sinqerta për ndarjen nga jeta të Prof. Dr. Elmaz Leci, një personalitet i shquar i mendimit akademik dhe një figurë e rëndësishme e shtypit ushtarak shqiptar.

Prof. Leci ka qenë pjesë e pandarë e shtypit ushtarak ndër vite, duke kontribuar me profesionalizëm, përkushtim dhe integritet në informimin, analizën dhe pasqyrimin e çështjeve të mbrojtjes dhe historisë ushtarake. Puna e tij si gazetar, redaktor dhe studiues la gjurmë të qëndrueshme në këtë fushë dhe mbetet një referencë e vyer për brezat që vijnë.

Në këto momente të vështira, Redaksia e Shtypit Ushtarak u gjendet pranë familjes, miqve dhe bashkëpunëtorëve të tij, duke ndarë dhimbjen për këtë humbje!

U prehtë në paqe!

Kujtimi i tij do të mbetet i përjetshëm.



Universi me shtatë dimensione, një teori që sfidon shkencën tradicionale

Në kohën e sotme, kur shkenca moderne përpiqet të depërtojë gjithnjë e më thellë në misteret e universit dhe të japë shpjegime për fenomenet që sfidojnë mendjen njerëzore, po shfaqet një ide e re që trondit themelet e fizikës tradicionale. Kjo hipotezë e guximshme sugjeron se universi nuk është i kufizuar vetëm në katër dimensionet që ne perceptojmë, tre dimensionet hapësinore dhe një dimension kohor, por është një strukturë shumë më e ndërlikuar, e përbërë nga shtatë dimensione.

Ky koncept hap një horizont të ri mendimi, duke na ftuar të imagjinojmë realitetin jo si një hapësirë lineare dhe të thjeshtë, por si një rrjet kompleks ku dimensionet e dukshme ndërthuren me dimensione të fshehura, të cilat nuk mund të kapen nga shqisat tona. Në këtë kuadër, universi shfaqet si një sistem i shumëfishtë, ku energjia, materia dhe koha nuk janë thjesht elementë të pavarur, por pjesë e një strukture të gjerë që ruan informacionin dhe ekuilibrin e ekzistencës.

Kjo ide e shtatë dimensioneve nuk është vetëm një lojë teorike e matematikës, por një përpjekje për të dhënë përgjigje ndaj pyetjeve që kanë mbetur të pazgjidhura për dekada: çfarë ndodh me informacionin kur bie në një vrimë të zezë, çfarë është materia e errët që përbën shumicën e masës së universit, dhe si mund të pajtohen dy shtyllat e fizikës moderne, relativiteti i përgjithshëm dhe mekanika kuantike. Nëse kjo hipotezë do të vërtetohet, ajo do të ndryshonte rrënjësisht mënyrën si e kuptojmë realitetin, duke e shndërruar universin nga një hapësirë katërdimensionale në një strukturë shumëdimensionale, ku çdo shtresë e fshehur mund të mbajë çelësin e mistereve kozmike.

Bazat e teorisë: Dimensionet e padukshme dhe struktura G2-manifolds

Pinčák argumenton se përveç katër dimensioneve të njohura, ekzistojnë edhe tre dimensione të fshehura, të mbështjella në struktura gjeometrike të quajtura G2-manifolds. Këto janë forma matematikore komplekse që shfaqen në teorinë e fijeve (string theory) dhe që mund të shpjegojnë mënyrën se si universi ruan informacionin dhe energjinë.

Në këtë model, çdo pikë e hapësirës nuk është thjesht një koordinatë, por një sistem i ndërlikuar që përmban shtresa të padukshme të realitetit. Këto dimensione shtesë mund të jenë të mbështjella brenda hapësirës që ne perceptojmë, duke ndikuar në mënyrën si graviteti, drita dhe materia ndërveprojnë.

Paradoksi i informacionit në vrimat e zeza

Një nga problemet më të mëdha të fizikës moderne është paradoksi i informacionit në vrimat e zeza, i ngritur nga Stephen Hawking. Sipas teorisë klasike, çdo informacion që bie në një vrimë të zezë zhduket përgjithmonë, duke sfiduar ligjet e ruajtjes së energjisë dhe informacionit.

Pinčák propozon një zgjidhje intriguese: informacioni nuk zhduket, por transformohet në një formë të padukshme që mund të jetë pikërisht materia e errët. Sipas tij, mbetet e vrimave të zeza, energjia dhe informacioni i “ngjeshur” në dimensionet e fshehura, mund të përbëjnë masën e padukshme që mban universin të lidhur.

Pasojat e mundshme për shkencën

Nëse kjo teori vërtetohet, ajo do të kërkojë një rishikim të plotë të ligjeve të fizikës:

- Rishikimi i konceptit të hapësirës dhe kohës: Dimensionet e fshehura mund të ndryshojnë mënyrën si e kuptojmë gravitetin dhe lëvizjen e trupave qiellorë.

- Shpjegimi i materies së errët: Kjo teori ofron një interpretim elegant për një nga misteret më të mëdha të kozmologjisë, se materia e errët mund të jetë energji e ruajtur në dimensione të padukshme.

- Pajtimi i dy shtyllave të fizikës moderne: Mekanika kuantike dhe relativiteti i përgjithshëm, që shpesh bien ndesh, mund të gjejnë një pikë takimi në këtë model me shtatë dimensione.



- Zgjerimi i teorisë së fijeve: Nëse G2-manifolds janë realitet fizik, ato mund të shërbejnë si ura mes teorisë së fijeve dhe përshkrimit të universit të vëzhgueshëm.

Skepticizmi dhe sfidat

Megjithëse ideja është magjepsëse, komuniteti shkencor mbetet i ndarë. Shumë fizikanë e shohin këtë teori si një model matematikor elegant, por pa prova eksperimentale ajo mbetet spekulative.

Teoria e fijeve ka sugjeruar prej kohësh ekzistencën e 10 ose 11 dimensioneve, por asnjë eksperiment nuk ka arritur t'i vërtetojë. Sfidat më të mëdha janë mungesa e mjeteve për të matur ose për të parë këto dimensione të fshehura.

Disa studiues argumentojnë se efektet e tyre mund të jenë të dukshme vetëm në shkallë mikroskopike, shumë më të vogla se çdo gjë që mund të vëzhgojmë me teknologjinë aktuale.

Perspektiva filozofike dhe njerëzore

Përtej matematikës, kjo teori ngre pyetje të thella filozofike: Nëse ekzistojnë dimensione që nuk mund t'i perceptojmë, a është realiteti që shohim vetëm një pjesë e së vërtetës?

Kjo ide na kujton se perceptimi njerëzor është i kufizuar dhe se universi mund të jetë shumë më kompleks se sa mund ta imagjinojmë.

Në një farë mënyre, teoria e shtatë dimensioneve është

një ftesë për përulësi intelektuale, për të pranuar se dija jonë është ende në fillimet e saj.

Për publikun e gjerë, ideja e shtatë dimensioneve mund të tingëllojë si fantashkencë, por në laboratorët e fizikës teorike ajo është një përpjekje serioze për të zgjidhur mistere që kanë sfiduar mendjet më të ndritura për dekada.

Nëse dikur Albert Einstein ndryshoi mënyrën si e kuptojmë kohën dhe hapësirën, sot studiues si Pinčák po përpiqen të zgjerojnë horizontin e njohjes përtej kufijve të perceptimit njerëzor.

Ky debat na kujton se shkenca është një proces i gjallë, ku çdo teori e re hap horizonte të reja dhe na shtyn të mendojmë përtej asaj që duket e mundur.

Një univers më i gjerë se imagjinata jonë

Universi me shtatë dimensione është një hipotezë që, nëse vërtetohet, mund të ndryshojë rrënjësisht mënyrën si e kuptojmë realitetin.

Edhe pse ende pa prova konkrete, ajo na kujton se dija njerëzore është gjithmonë në lëvizje dhe se misteret e universit janë shumë më të mëdha se sa mund të përfytyrojmë.

Në fund, ndoshta universi nuk është vetëm një hapësirë e pafund, por një strukturë shumëdimensionale e ndërthurur me energji, informacion dhe vetë ndërgjegjen tonë, një realitet që pret të zbulohet.



Njoftim

Qendra e Personel Rekrutimit ka filluar regjistrimet e kandidatëve për rezervistë dhe kërkon të rekrutojë 363 kandidatë.

Data e fillimit të stërvitjes: 1 tetor 2026.

Kategoritë që do të rekrutohen:

- | | |
|---|--------------------------------------|
| ☐ Oficer rezervist | 47 (dyzetë e shtatë) kuota |
| ☐ Nënoficer rezervist | 132 (njëqind e tridhjetë e dy) kuota |
| ☐ Ushtar / detar rezervist | 170 (njëqind e shtatëdhjetë) kuota |
| ☐ Mjek / infermier rezervist | 14 (katërmëdhjetë) kuota |

Afati për dorëzimin e dokumentacionit është deri më: 31 korrik 2026